



AMSHC mbyll me sukses ciklin e trajnimit të OJF-ve në kuadër të Thirrjes nr. 7

24, 26 shkurt dhe 2 mars 2015



AMSHC mbyll me sukses ciklin e trajnimeve të organizuara në kuadër të Thirrjes nr. 7 për projekt-propozime, me synim dhënie të asistencës teknike për një aplikim të suksesshëm, me përfaqësues të OJF-ve dhe gjithë aktorëve të tjerë të Shoqërisë Civile në qytetet Shkodër, Pogradec dhe Tiranë, në datat 24, 26 shkurt dhe 2 mars 2015.

Në këto trajnime u vu re një pjesëmarrje dhe interesim i gjerë i përfaqësuesve të OJF-ve në përgjithësi dhe sidomos atyre të sapo formuara apo rinore, dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zonat rurale. Ecuria dhe mbarëvajtja e këtij procesi të domosdoshëm ishte i suksesshëm. Pjesëmarrësit në këto trajnime morën shpjegime dhe udhëzime rreth plotësimit të formularit të aplikimit, paketës së dokumentacionit ligjor që shoqëron aplikimin si dhe pasqyrës financiare, përputhshmërisë së saj me aktivitetet e planifikuara etj.

Pjesëmarrja e madhe rreth 120 pjesëmarrës në këto takime, të konfirmuar paraprakisht edhe në rrugë elektronike në faqen e AMSHC-së tregoi rëndësinë e këtyre trajnimeve. Në fund pjesëmarrësit falënderuan AMSHC-në për ndihmën dhe asistencën e dhënë.

AMSHC mbyll me sukses ciklin e trajnimit të stafit të saj lidhur me hartimin e Projekt Propozimeve për programin IPA dhe donatorët e tjerë

Tiranë, 3, 4 dhe 5 mars 2015

AMSHC mbyll me sukses ciklin e trajnimit për rritjen e kapaciteteve të stafit të saj në lidhje me hartimin e projekt-propozimeve për programin IPA dhe donatorët e tjerë që operojnë në vend, të organizuara në bashkëpunim me USAID Albania, nëpërmjet një projekti të aplikuar nga AssistIMPCT, në datat 3, 4 dhe 5 mars 2015.

Ky trajnim zhvillohej në vijimësi të seminarit dy ditor që AMSHC-ja zhvilloi në datat 17 dhe 18 dhjetor 2014, për hartimin e Strategjisë së AMSHC-së 2015-2020, i cili u drejtua nga eksperti i fushës z.Christopher J. Varady.

Ne këtë trajnimi, stafi i AMSHC-së mori njohuri për të gjitha etapat dhe teknikat e hartimit të projekt-propozimeve, të cilat u prezantuan nga eksperti i fushës z, Christofer J. Varady dhe u bënë një sërë pyetjesh rreth rubrikave të veçanta të projekt-propozimit, si logframe, draftimi i buxheti etj.

Gjatë trajnimit u organizuan disa punë në grupe, ku pjesëmarrësit aplikuan konkretisht të gjitha njohuritë e marra dhe në të njëjtën kohë qartësuan dhe tejkaluan çdo vështirësi që hasën gjatë punës së tyre.

Në fund stafi i AMSHC-së së bashku me përfaqësuesit e AssistIMPCT falënderuan USAID Albania dhe trajnuesin për ndihmën dhe asistencën teknike të dhënë gjatë këtij trajnimi dhe u shprehën se këto trajnime janë gjithmonë të nevojshme.





AMSHC merr pjesë në Takime Konsultative Rajonale rreth Udhërrëfyesit të Politikave të Qeverisë Shqiptare me temë “Krijimi i një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”

5, 9, 10 dhe 11 mars 2015

Në vijim të përmbushjes së misionit të saj për mbështetjen financiare dhe teknike të shoqërisë civile për nisma qytetare në të mirë të komunitetit, si dhe në kuadër të forcimit të bashkëpunimit mes institucioneve qeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve), AMSHC merr pjesë në takime rajonale në datat 5, 9, 10 dhe 11 mars 2015, përkatësisht në Vlorë, Pogradec, Shkodër dhe Tiranë, me shoqërinë civile, rreth Udhërrëfyesit të Politikave të Qeverisë Shqiptare me temë “Krijimi i një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, të drejtuar nga Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me zyrën e projektit TACSO në Shqipëri. Takimet u drejtuan nga përfaqësuesi i Ministrisë së Integritimit, i cili në fjalën e tij parashtroi se Udhërrëfyesi është hartuar në përputhje të plotë me Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në vendet e zgjerimit, për periudhën 2014-2020, i cili synon të sigurojë një strukturë të qëndrueshme për matjen e progresit në zhvillimin, mundësimin dhe stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse në vendet që synojnë të aderojnë në BE.

Qëllimi kryesor i dokumentit synon në orientimin dhe krijimin e kushteve për Qeverinë Shqiptare në krijimin, apo dhe përmirësimin e mekanizmave ekzistues për vendosjen e urave të bashkëpunimit me shoqërinë civile, për të kontribuar në promovimin e qeverisjes dhe politikëbërjes gjithëpërfshirëse si dhe instalimin e një demokracie më funksionale në vend. U theksua gjithashtu, se draft dokumenti prezanton një program me 9 fusha prioritare veprimi, të cilat qeveria shqiptare është e angazhuar t'i zbatojë, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Më tej paneli drejtues i takimeve së bashku me të pranishmit, përfaqësues të shoqërisë civile diskutuan, shkëmbyen mendime dhe dhanë sugjerime rreth fushave prioritare të Udhërrëfyesit të Politikës së Qeverisë për një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, që ishin:

- 1. Institucione që mbështesin bashkëpunimin Qeveri-OSHC;*
- 2. Mjedisi politikash strategjike kombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile;*
- 3. Përfshirja e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes;*
- 4. Struktura financimi publik për programet e OSHC-ve;*
- 5. Kuadër i ri ligjor për regjistrimin dhe punën e OSHC-ve;*
- 6. Raportimi/kontabiliteti financiar dhe trajtimi tatimor i OSHC-ve;*
- 7. Mbledhja e të dhënave të vlefshme rreth zhvillimit të shoqërisë civile;*
- 8. Zhvillimi i vullnetarizmit;*
- 9. Kontributi i OSHC-ve në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë*

Në fund të takimeve organizatorët falënderuan pjesëmarrësit për prezencën e tyre dhe premtuan pasqyrimin e të gjitha mendimeve dhe sugjerimeve në draft dokumentin final. Gjithashtu, pjesëmarrësit falënderuan organizatorët dhe theksuan rëndësinë e madhe që kanë këto takime për të qënë sa më afër shoqërisë civile.



Lançohet: Observatori i Bashkëpunimit Rajonal në Vendet e Ballkan - "ORI"

Tiranë, 06 mars 2015

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në bashkëpunim me Institutin për Zhvillim dhe Bashkëpunim, si dhe Friedrich Ebert Stiftung organizuan sot më 6 mars 2015, tek Tirana Times Library, takim për lanchimin e Observatorit të Bashkëpunimit Rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor – "ORI".

ORI është një Databazë me 446 projekte rajonale dhe ndërkufitare ku marrin pjesë institucionet dhe organizatat shqiptare, të kompletuara me studime, analiza dhe raporte që trajtojnë integrimin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Në këtë takim ishin të pranishmen një numër i madh pjesëmarrësish. Të pranishmëve ju uroi mirëseardhjen z. Ilir Ciko, përfaqësues i Institutit për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Në takim morën fjalën z. Frank HANTKE, Drejtor i Friedrich Ebert Stiftung - Zyra Tiranë i cili foli për temën "Procesi i Berlinit dhe Bashkëpunimi Rajonal në Ballkanin Perëndimor", znj. Erisa XHIXHO,

Zëvendës Ministre e Integritit Evropian, me temë "Bashkëpunimi rajonal: Një objektiv kyç i strategjisë së integritit në BE të Qeverisë Shqiptare", z. Andi KANANAJ, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, i cili prezantoi temën "Shoqëria Civile Shqiptare si një partner kompetent dhe strategjik në bisedimet për përafrimin", z. Ardian Hackaj, Drejtor i Shtetiweb portal, Instituti i Zhvillimit dhe Bashkëpunimit i cili prezantoi "ORI: Të dhënat empirike në shërbim të politikave të bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal".



Gjatë takimit pati dhe shkëmbim pikëpamjesh rreth temës "Europa Juglindore-2020: Nxitja e procesit të integritit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian", me aktorët e tjerë kryesorë të pranishëm të tillë si z. Yngve Engstroem, përfaqësuesi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Nand SHANI, Ekspertit të lartë, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, në Sarajevë, znj. Fabiola Duro, Drejtores për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, dhe znj. Leila HAXHIQI, Drejtore Ekzekutive, Trashëgimia Kulturorë pa Kufij, Zyra Tiranë.

Në fund të takimit z. Ilir Ciko, përfaqësues i Institutit për Zhvillim dhe Bashkëpunim bëri një përmbledhje të konkluzioneve dhe u përcaktuan hapat e mëtejshme që do të ndiqen në të ardhmen.

Workshop për plotësimin e matricës së Udhërrëfyesit

Tiranë, 12 mars 2015



AMSHC me anë të përfaqësuesit të saj z. Erion Banushi, mori pjesë në workshop-in për plotësimin e matricës së monitorimit të Udhëzuesit për mbështetjen nga BE të Shoqërisë Civile për periudhën 2014-2020.

Qëllimi i workshopit ishte diskutimi lidhur me plotësimin e Udhëzuesit me treguesit e targetuar në nivel kombëtar.

Ky takim pati pjesëmarrjen e disa organizatave të shoqërisë civile dhe arriti të përfundojë targetimet për strategjinë me anë të kontributit të të gjithë pjesëmarrësve.

AMSHC falënderon zyrën e TACSO në Shqipëri për organizimin dhe shpreh mbështetjen e plotë për çdo iniciativë që forcon rolin e shoqërisë civile në konsultime dhe vendimmarrje.

Organizatat pjesëmarrëse në këtë takim:

CRCA; ANTTARC; AWEN; A.I.S.I.; ACER; Përtej Barrierave; VIS Albania; ISPL; Roma Active Albania; Këshilli Rajonal Rinor; Co-Plan; Observatori për të Drejtat e Njeriut; Urban Research Institute; EDEN; REC Shqipëri; Gjirokastra Foundation; ARSIS; Partners Albania.

AMSHC merr pjesë në konferencën "24 VJET PARTNERITET STRATEGJIK"

Tiranë, 16 mars 2015



AMSHC me anë të përfaqësuesit të saj z. Kastriot Tota, mori pjesë në konferencën "24 VJET PARTNERITET STRATEGJIK - Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane ndër vite", të organizuar nga Albanian Policy Center, ku ishin të pranishëm shumë personalitete nga jeta publike në vend.

Të pranishëm dhe folës kryesorë:

- Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij Z. Bujar Nishani
- Ambasadori Amerikan në Tiranë, Shkëlqesia e Tij Z. Donald Lu
- Kryetare e Komisionit të Jashtëm të Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Arta Dade
- Deputet i Partisë Demokratike dhe Anëtar i Komisionit të Jashtëm të Kuvendit, Z. Eduard Selami

Me anë të kësaj konference u theksua edhe një herë rëndësia e këtyre marrëdhënieve në përvjetorin e tyre. Eksperienca e këtyre marrëdhënieve dhe vendosja e tyre në kontekstin strategjik e interesin vital për kombin shqiptar vazhdon të mbetet objekt studimi, por gjithashtu edhe krenari kombëtare, të cilën shqiptarët e ruajnë me krenari.

Takim trajnues lidhur me detyrimet e parashikuara në Ligjin për të Drejtën e Informimit

Tiranë, 17 mars 2015



AMSHC me përfaqësuesin e saj Z. Alkent Shehaj mori pjesë në takimin trajnues, ku Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale së

bashku me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë kanë zhvilluar me rreth 200 përfaqësues të institucioneve shtetërore qendrore dhe të varësisë për t'i trajnuar në lidhje me detyrimet e parashikuara në Ligjin për të Drejtën e Informimit. Në fjalën e hapjes Komisioneri Dervishi theksoi rëndësinë e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit në kuadër të transparencës së administratës publike me qytetarët. Komisioneri i rikujtoi të gjithë përfaqësuesve të autoriteteve publike se edhe pse kanë kaluar disa muaj nga miratimi i ligjit, shumë prej detyrimeve të përcaktuara në të akoma mbeten të pazbatuara. "Deri më tani, nuk kemi vendosur sanksione administrative edhe pse ligji na detyron, por ne jemi nisur nga parimi se qëllimi i ligjit nuk është vendosja e sanksionit, por zbatimi i tij. Deri më sot kjo është mbajtur si përgjegjësi nga Komisioneri, por nga nesër do ta ndajmë së bashku".

Nis në Tiranë procesi i konsultimit të Draftit final për projektligjin për "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Tiranë, 17 mars 2015



Në sallën e madhe të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nisi në Tiranë procesi i konsultimit të Draftit final për projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile".

Ky proces konsultimi udhëhiqet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim të ngushtë me AMSHC-në dhe Grupin Teknik të Punës.

AMSHC merr pjesë në dy evente të organizuara nga Volonteurope, në Riga, Letoni

Riga (Letoni), 26 - 27 mars 2015

Më 26 - 27 mars 2015, AMSHC, përfaqësuar nga kryetari i Bordit Mbikëqyrës, Z. Adrian Thano, dhe anëtari i Bordit Mbikëqyrës Z. Ismail Ademi, mori pjesë në seminarin dhe konferencën, e organizuar nga Volonteurope në Riga, Letoni. Seminari u organizua me temë "Izolimi Rural i Qytetarëve në Evropë", të enjte 26 mars 2015, dhe Konferenca e Volonteurope ishte rreth temës "Vizioni për të Mirën e Përbashkët për Evropën", të premte 27 mars 2015, Shkolla e Ekonomisë e Stokholmit, Riga, Letoni.

Pjesëmarrësit në këto evente përfaqësonin një numër të madh përfaqësuesish nga sektorë publik dhe privat, shoqëria civile, si dhe të komuniteteve dhe nismëtarëve të lëvizjeve.

Për organizimin e këtyre eventeve ishte bërë një punë e gjatë përgatitore nga anëtarët e rrjetit Volonteurope, shoqërisë civile dhe partnerëve institucionalë, që prej gjysmës së dytë të 2014.

Këto evente, u organizuan në bashkëpunim me partnerë nga e gjithë Evropa, të cilët kanë për qëllim të çojnë përpara punën rreth çështjes "Izolimi Rural i qytetarëve në Evropë" si dhe të shërbente si nisje zyrtare e fushatës së grupeve të interesit, të titulluar "E mira e Përbashkët për Evropën".

Izolimi Rural, në të gjithë BE-në, mund të adresohet përmes politikave publike, angazhimit të qytetarëve dhe përfshirjes së shoqërisë civile. Volonteurope, një rrjet ndërkombëtar i cili promovon vullnetarizmin, qytetarinë aktive dhe drejtësinë sociale, është i

angazhuar në një fushatë dy - vjeçare me temë "Izolimi Rural i qytetarëve në Evropë". Kjo fushatë ka për qëllim të evidentojë sfidat me të cilat përballen komunitetet rurale dhe të identifikojë zgjidhjet e mundshme të këtyre sfidave. Me organizimin e kësaj konference, rrjeti Volonteurope synoi të kalojë në një fazën tjetër të fushatës së tij që ka të bëjë me ngritjen e debatit rreth vizionit mbi "E Mira e Përbashkët për Evropën". Konferenca, në vetvete, ishte një mundësi e shkëlqyer për ta bërë këtë.

Fushata nën moton "E Mira e Përbashkët për Evropën", mbështetet nga disa parime, ku përfshihen:

- **Gjithë Përfshirja:** të gjithë sektorët, duke punuar së bashku për të siguruar gjithë secilin përfshirë dhe personat më vulnerabël, mund të përfitojnë nga mundësi, lumturi dhe pasuri që janë në dispozicion, në shoqëri;
- **Bashkëpunimi:** njerëz që veprojnë së bashku për të bërë një ndryshim dhe për të nxitur ndryshime pozitive;
- **Vizion afatgjatë:** trajtim të sfidave urgjente me të cilat përballlet Evropa, ndërkohë që është e vetëdijshme për nevojat e gjeneratave të ardhshme dhe të qëndrueshmërisë mjedisore;
- **Drejtësia:** pavarësisht zgjedhjes individuale, çdo kush duhet të ketë qasje të barabartë në mundësitë dhe në pjesëmarrjen në jetën demokratike.

Takimi konsultativ në qarkun e Shkodrës për Draftin final të projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Shkodër, 31 mars 2015



Shkodra ishte destinacioni i rradhës në procesin e konsultimit me Organizatat e Shoqërisë Civile në 12 qarqet e Shqipërisë për diskutimin e draftit final të projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile".

Takimi u zhvillua në qendrën kulturore "Arka" dhe nisi me prezantimin e projektligjit nga përfaqësuesi i Shërbimit Kombëtar për Rininë, i cili shpjegoi në vija të përgjithshme qëllimet, parimet dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Përfaqësuesi i organizatës DeP pyeti se në cilat praktika ndërkombëtare është bazuar krijimi dhe funksionimi i KKSHC-së. Përfaqësuesja e AMSHC-së solli si shembull praktikën kroate dhe mirëfunksionimin e këtij Këshilli të ngjashëm në Kroaci.

Pjesëmarrësit pranuan se nuk e kishin marrë projektligjin në mënyrë elektronike dhe si rrjedhim nuk ishin në dijë për të. Ato shprehën dëshirën për të zhvilluar një takim të dytë ku do të kishin mundësi të jepnin rekomandimet e tyre mbi draft ligjin.

Përfaqësuesja e AMSHC-së, Znj. Çorbaxhi shpjegoi se projektligji është i afishuar në faqen zyrtare të internetit të AMSHC dhe cdo kush mund ta aksesojë.

Përfaqësuesi i Shërbimit Kombëtar për Rininë, Z. Loka sugjeroi që të organizatat pjesëmarrëse të nisin rekomandimet e tyre me shkrim, në një dokument të gjatë maksimumi një faqe A4 dhe t'i dërgojnë në adresat e përfaqësuesve të Ministrisë dhe AMSHC-së. Në këtë mënyrë rekomandimet do të jenë më konkrete.

Microsoft NGO Connection Day "Roli i Teknologjisë në Zhvillimin e Komunitetit"

Tiranë, 31 mars 2015



Microsoft NGO Connection Day i kushtohet organizatave të shoqërisë civile duke u mundësuar akses në teknologji të Informacionit dhe Komunikimit nëpërmjet produkteve të Microsoft software dhe licensave.

I ftuar në këtë takim ishte edhe Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, Z. Andi Kananaj, i cili foli mbi teknologjinë në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit shoqëror.



Përgjatë këtij eventit organizatat pjesëmarrëse u informuan më shumë mbi shfrytëzimin e mundësive që Microsoft ofron nëpërmjet programit Youth Spark, aplikacioneve për software (grante për software të licencuar falas) si dhe platformën e re Office 365.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth përdorimit të teknologjisë dhe rrjeteve sociale për arritjen e prezencës më të mirë në internet, që t'ju shërbejnë më mirë komunitetit ku ato punojnë.

Takimi konsultativ në qarkun e Gjirokastrës për Draftin final të projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Gjirokastrë, 3 prill 2015



Vazhdojnë takimet nëpër qarqet e Shqipërisë për t'u konsultuar me përfaqësuesit e Shoqërisë Civile mbi projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile".

Destinacioni i radhës ishte Qarku i Gjirokastrës dhe tryeza e rrumbullakët u plotësua me pjesëmarrës nga 7 organizata të shoqërisë civile. Takimi u zhvillua në formën e bashkëbisedimit, moderuar nga z. Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) dhe me ndihmesën e z. Kreshnik Loka, Jurist dhe Koordinator Projektsh pranë Shërbimit Kombëtar për Rininë.

Z. Kananaj prezantoi një informacion të përgjithshëm mbi projektligjin dhe arsyet e inicimit të tij.

Përfaqësuesi i Fondacionit "Gjirokastra", z. Sadi Petrela, shprehu skepticizmin e kolegëve të tij mbi implementimin e drejtë të ligjit. Ai mendon se draft ligji do të jetë produktiv për OSHC-të në rast se zbatimi i tij bëhet në mënyrën korrekte. Ai propozon që tryeza konsultative me përfaqësues nga OSHC-të në të gjithë vendin të zhvillohen jo vetëm për draft ligjin, por edhe për miratimin e Rregullores së KKSHC-së, e cila do të funksionojë si dokumenti bazë i Këshillit. Z. Kreshnik Loka plotëson se projektligji do të rregullojë vetëm zgjedhjet e para të KKSHC-së dhe në mbledhjen e parë e tij do të miratohet Rregullorja. Draft ligji vjen i hartuar në terma të përgjithshëm me qëllimin që Rregullorja të jetë dokumenti ligjor i detajuar, ku do të bazohet organizimi dhe funksionimi i KKSHC-së.

Z. Kananaj thekson rëndësinë e madhe të zgjedhjeve të përfaqësuesve të OSHC-ve në KKSHC. Kjo pikë shihet prej tij si një moment kyç, i cili kërkon idetë dhe opinionet e të gjithë aktorëve të shoqërisë civile për të arritur në një produkt gjithëpërfshirës dhe të pranuar nga masa e gjerë.

Pjesëmarrësit, unanimisht, theksojnë rëndësinë e gjithëpërfshirjes gjeografike të OSHC-ve në Këshill. Një nga pjesëmarrësit propozon të ketë vende të përcaktuara nga çdo qark i Shqipërisë.

Z. Kananaj, argumenton se ky propozim do të jetë i vështirë për t'u zbatuar pasi mund të ndodhë që disa nga qarqet mund të veprojnë më së shumti në të njëjtën fushë ekspertize.

Z. Loka plotëson se projektligji ka menduar për një ndarje sipas fushës së ekspertizës dhe jo sipas shpërndarjes gjeografike për të shmangur mbivendosjen ose përpjestimin e zhdrejtë të përfaqësimit të organizatave që veprojnë në të njëjtën fushë.

Përfaqësuesi i Fondacionit "Gjirokastra" propozon se pjesa e përfaqësimit gjeografik mund të lehtësohet, duke mos vendosur kuota të caktuara për çdo qark, por duke organizuar takime dhe tryeza të rrumbullakta, periodike me OSHC-të që punojnë në të gjitha qarqet e Shqipërisë për të mbledhur rekomandimet dhe komentet e tyre. Ai shton se në disa fusha të caktuara, si turizmi në Gjirokastrë, OJF-të kanë më shumë eksperiencë se shteti për shkak të punës shumë vjeçare dhe elementëve të tjerë në disfavor të shtetit si rotacioni politik.

Një mendim tjetër nga të ftuarit, disi më larg objektit të projektligjit, ishte dhe delegimi i disa kompetencave specifike nga qeveria vendore tek OJF-të (p.sh. menaxhimi i Kalasë së Gjirokastrës). Kjo vjen si vazhdimësi e propozimit të dhënë nga z. Petrela mbi nivelin e eksperiencës së OJF-ve.

Z. Loka plotëson këtë propozim duke sjellë në vëmendjen e të pranishmëve se një nga rrisitë e këtij projektligji është edhe e drejta e KKSHC-së për të rekomanduar Qeverinë mbi shpërndarjen e fondeve publike dhe për analizën vjetore të ministrive dhe agjencive qeveritare rreth projekteve dhe programeve të financuara. Kjo është një mundësi më shumë për të lehtësuar bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore.

Takimi konsultativ në qarkun e Korçës për Draftin final të projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Korçë, 10 prill 2015



Rrugëtimi i takimeve konsultative mbi projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" përmbyllet në qarkun e Korçës. Në tryezën e rrumbullakët u bashkuan për të diskutuar pjesëtarë të shtatë organizatave jofitimprurëse si dhe përfaqësues të bashkisë dhe qarkut Korçë.

Në takim ishin pjesëmarrës dhe përfaqësues nga Shërbimi Kombëtar për Rininë dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Fillimisht u mbajt një prezantim i shkurtër i projektligjit nga SHKR-ja me dëshirën për të theksuar disa nga pjesët më të rëndësishme të këtij dokumenti.

Përfaqësuesi nga organizata "Natyra dhe Jeta" nis diskutimin duke shprehur skepticizëm mbi projektligjin dhe duke theksuar se ky është një Këshill jo i kontrolluar nga OJF-të, por një instrument shtetëror i cili rrezikon pavarsinë e OSHC-ve. Ligji egzistues për funksionimin dhe organizimin e OJF-ve, sipas tij përfshin vetëm 1/9 e shërbimeve të shoqërisë civile. Ai thekson se në Shqipëri mungon një ligj për Shoqërinë Civile ku të përcaktohet se çfarë përfshihet në termin OSHC. Kjo mungesë e bën të vështirë analizën e mëtejshme të këtij projektligji. Gjithashtu ai vë në dukje se vet projektligji, në nenin 2, jep një përkufizim të OSHC-së, por më pas trajton vetëm OJF-të duke lënë jashtë një pjesë të shoqërisë civile. Ky është një konstatim i hasur dhe më parë.

Përfaqësuesi i organizatës "Natyra dhe Jeta" sjell në kujtesë dhe organizimin e OJF-ve në Korçë, Aleanca e Shoqërisë Civile, ku ato kishin krijuar një rrjet komunikimi midis tyre. Ai propozoi se ligji duhet të parashikojë një organizim të tillë dhe jo një organizim shtetëror. Përfaqësuesi i SHKR-së argumentoi se bashkimi OJF-ve duhet të bëhet në mënyrë të pavarur nga vetë organizatat dhe mos të pritet nga shteti të rregullohet kjo pjesë. Janë vetë OSHC-t të cilat duhet të gjejnë rrugën e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin mes tyre. Projektligji në fjalë krijon një urë më shumë bashkëpunimi për ti dhënë të drejtën ligjorë OSHC-ve të këshillojnë Qeverinë.

Znj. Lameborshi, përfaqësuesja e AMSHC-së, plotësoi duke përmendur se në Udhërrëfyesin për OJF-të, i cili është në fazë konsultative, përcakton rregullimin e përkufizimit të OSHC-ve në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Një tjetër pjesëmarrës mendonte se raporti i përfaqësimit në KKSHC duhet të anojë nga ana e OJF-ve. Znj. Ristani, Drejtoreshë e Përgjithshme e SHKR-së argumentoi se ndarja e barabartë midis përfaqësuesve të shtetit dhe të OJF-ve është për të rritur nivelin e debatit midis palëve në mënyrë që rekomandimet e nxjerra të kenë marrë një konsensus të gjerë nga institucionet shtetërore dhe të jenë rrahur nga të dyja palët (Shtet-OJF). Në rastin se përfaqësuesit e OJF-ve në Këshill do të kishin mazhorancën, kjo do të ulte nivelin e diskutimit dhe OJF-të do të mund të gjendeshin përballë barrierave të mëtejshme.

Një sugjerim tjetër vjen lidhur me përfaqësimin e OSHC-ve në Këshill duke propozuar që njëri nga përfaqësuesit të jetë nga minoritetet. Në takim u shpjegua se përfaqësimi në nivel gjeografik nuk është përfshirë në projektligj, për të shmangur përfaqësimin më të lartë të organizatave me mision të njëjtë.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe AMSHC përmbyllën me sukses procesin e konsultimit të draftit ligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Prill 2015

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) përmbyllën me sukses, procesin e takimeve rajonale me organizata dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile lidhur me konsultimin e gjerë të Projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile". Në këto takime morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), AMSHC-ja, grupi teknik i punës si dhe përfaqësues nga

organizatat dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile. Organizatorët e takimeve theksuan se ky projektligj ka për qëllim krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile në Shqipëri.

Ai rregullon krijimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, si një strukturë këshillimore dhe e pavarur pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për të garantuar bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri në dobi të zgjerimit të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë, rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike, nëpërmjet përfshirjes sa më të gjerë të shoqërisë civile në këtë proces. Projektligji që u paraqit për shqyrtim në këto takime është hartuar duke mbajtur parasysh parimet e shprehura në rezolutën e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë "Për procesin e integritimit Evropian të Shqipërisë" si dhe vjen në përputhje me rekomandimin kryesor të përfaqësuesve të nivelit të lartë të Bashkimit Evropian.

Gjatë takimeve u theksua se shoqëria civile në vendin tonë ka dhënë kontribut të madh në drejtim të respektimit, promovimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut, forcimit të shtetit të së drejtës dhe të një shoqërie të drejtë, të hapur dhe demokratike. Ajo ka dhënë kontribut konkret përmes nismave ligjore për hartimin e ligjeve të reja ose përmirësime të tyre, monitorimit të respektimit të standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare në fusha të ndryshme dhe ndërgjegjësimit të publikut për rolin e tij në një shoqëri demokratike, në forcimin e bashkëpunimit dhe kohezionit social në rajon dhe më gjerë.

Në vijimësi të kësaj, pjesëmarrësit diskutuan dhe shprehën lirshëm mendimet e tyre për secilin nen të projektligjit dhe vunë theksin në nevojën e avancimit të reformave në lidhje me:

1. *Përmirësimin e kuadrit ligjor dhe fiskal për veprimtarinë e shoqërisë civile;*
2. *Rritjen e transparencës së punës së institucioneve publike;*
3. *Konsultimin e gjerë të nismave të reja ligjore me shoqërinë civile, dhe forcimin e kapaciteteve*

Procesi konsultativ u karakterizua nga gjithëpërfshirja, transparenca, efektiviteti, dialogu dhe përgjegjshmëria.

Në përfundim të takimeve organizatorët garantuan se do të ketë vlerësimi me objektivitet të mendimeve dhe rekomandimeve të dala gjatë procesit konsultues dhe se rezultatet që do të dalin nga ky proces do të gjejnë pasqyrim në hartimin e draftit final të projektligjit.



Trajnim në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit të AMSHC-së

Pogradec, 22 - 24 prill 2015



Në vijim të punës dhe përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit të saj, AMSHC mori pjesë në trajnimin 3 ditor të organizuar nga zyra TACSO-Abania në qytetin e Pogradecit, nga data 22 - 24 prill 2015. Ky trajnim u organizua në kuadër të mbështetjes së institucioneve qeveritare që janë përgjegjëse për zhvillimin e një shoqërie civile të qëndrueshme dhe gjithë përfshirëse.



Tema e këtij trajnimi ishte "Zhvillimi dhe Menaxhimi Organizativ i OSHC-ve". Qëllimi i tij ishte të rrisë kapacitetet e Agjencisë në fushën e planifikimit strategjik, si dhe atë të menaxhimit të OJF-ve, me qëllim që të plotësohen më së miri nevojat e shoqërisë civile në Shqipëri. Organizimi i këtij trajnimi ka lidhje dhe me një nga prioritetet e theksuara në Udhërrëfyesin për politikën e qeverisë shqiptare që është sigurimi i një mjedisi sa më mundësues dhe të përshtatshëm për zhvillimin e shoqërisë civile.



Gjatë 3 ditëve u trajtuan disa tema të rëndësishme dhe konkretisht temat që lidhen me standardet e OJF-ve ndërkombëtare, krijimin i një mjedisi mundësues për OJF-të, qeverisja e bordeve të OJF-ve si dhe menaxhimi ekzekutiv, përgjegjësitë e bordeve si dhe konceptet bazë të zhvillimeve organizative dhe sistemeve operacionale të OJF-ve, qëndrueshmëria e organizatave jo fitim prurëse, planifikimi strategjik dhe organizativ i organizatës, funksionimi i sistemit të brendshëm, politikën dhe procedurat e organizatës, zhvillimi i projekteve, vlerësimi dhe monitorimi i tyre si dhe komunikimi me grupet e interesit, kryesisht media etj. Në fund trajnimi konkludoi me dhënien e certifikatave për të gjithë pjesëmarrësit.

Drejtori Ekzekutiv, z. Andi Kananaj sëbashku me stafin e AMSHC-së falënderuan zyrën e TACSO Albania dhe ekspertët që udhëhoqën trajnimin dhe premtuan për një bashkëpunim të vazhdueshëm në të ardhmen.



Seminar i organizuar nga Instituti për Politika Publike dhe Private (IP3)

Tiranë, 23 prill 2015

Me ftesë të Institutit për Politika Publike dhe Private (IP3), përfaqësuesi i AMSHC-së, Z. Erion Banushi, mori pjesë në seminarin e organizuar nga ky institut në kuadër të projektit të financuar nga AMSHC me titull "Mbështetja dhe konsolidimi i mekanizmave institucionale dhe instrumentave financiare për promovimin e zhvillimit rajonal në vend". Ky projekt synon të rrisë efektshmerinë e mekanizmave institucionale për zhvillimin rajonal, duke siguruar që rajonet të kenë një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të komuniteteve, duke përdorur burimet e tyre unike.

AMSHC merr pjesë në konferencën rajonale të TACSO e zhvilluar në Beograd, Serbi: "Monitorimi i Udhëzimeve të BE-së - viti 1"

Beograd (Serbi), 28 – 30 prill 2015

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së, Z. Andi Kananaj së bashku me Z. Erion Banushi, morën pjesë në konferencën rajonale në Beograd, të organizuar nga Asistenca Teknike për Organizata të Shoqërisë Civile (TACSO), me temë "Monitorimi i Udhëzimeve të BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020 – viti 1".



Qëllimi i kësaj konference është që të kontribuojë në mënyrë të vazhdueshme në udhëheqjen e proceseve drejt ndryshimeve të dëshiruara në të gjitha vendet e përcaktuara nga 'Udhëzuesi për mbështetje nga BE-ja të shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014-2020.

Ky Udhëzues është konsideruar si një "dokument politik tolerant" i cili synon të shërbejë si dokument kyç i Bashkimit Evropian për monitorimin, raportimin dhe programimin e çështjeve që lidhen me organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të).

Udhëzimet e BE-së, rreth të cilave u diskutua, kanë të bëjnë me çështjet si: mjedis më të mirë ligjor për funksionimin e OSHC-ve, përmirësim i mekanizmave dhe strukturave të nevojshme për dialog dhe konsultime ndërmjet qeverive dhe organizatave të shoqërisë civile, përmirësim i kapaciteteve të OSHC-ve në mënyrë që ato të jenë më transparente, më të përgjegjshme, me misioni të qartë, të respektuar nga të gjithë dhe të prekshëm për komunitetet e tyre, si dhe të qëndrueshme sa i përket financave të tyre dhe burimeve njerëzore. Progresi me objektivat e vendosura nga Udhëzimet e BE-së do të mundësojë dhe krijojë një shoqëri civile të fortë dhe dinamike që do të kontribuojë në zgjerimin e mëtejshëm të pluralizmit dhe demokratizimit të shoqërive. Gjatë Konferencës, pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutonin gjithashtu rreth të dhënave për Progres Raportin e vendit për 2015 në lidhje me konstatimet gjatë 2015 kundrejt Udhëzimeve të BE-së. Ata shqyrtuan dhe diskutuan rreth mekanizmave dhe metodave të ndryshme, të cilat do të lejojnë organizimin e sistemeve pjesëmarrëse kombëtare të monitorimit të Udhëzimeve të BE-së. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia, si dhe përfaqësues të institucioneve të BE-së.

Shpallet lista e projekteve fituese të Thirrjes Nr. 7

Maj 2015

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) falënderon të gjithë aplikantët pjesëmarrës në këtë thirrje për interesin e shprehur me projekt-propozime.